



It's time to stop illegal wildlife poisoning in the Balkans!

The intentional placement of poison baits is a harmful and painful method of killing animals that does not discriminate among species. It can drive protected species like vultures to extinction and kill livestock, pets and other domesticated animals. People are also not safe since exposure to poison baits can lead to serious illnesses and even death.

The most common motive behind this practice is to target domestic, feral or wild predators that may inflict damage on livestock and game species. However, poisoning, which is also an environmental crime punishable by law, is not a solution. Several safe preventive measures that help resolve human-wildlife conflicts are available, including electric fences, foxlights, fladry systems and livestock guard dogs.

The BalkanDetox LIFE project combats illegal wildlife poisoning across Albania, Bosnia and Herzegovina, Bulgaria, Croatia, Greece, the Republic of North Macedonia and Serbia by shifting the perceptions and behaviour of all relevant stakeholders, from the decision-makers to the general public and the actual users of poison baits.

Learn more at www.balkandetoxlife.eu



EURONATUR



VULTURE
CONSERVATION
FOUNDATION



ALBANIAN ORNITHOLOGICAL
SOCIETY



PPNEA



Është koha të ndalojmë helmimin e paligjshëm të faunës së egër në Ballkan! ÇFARË ËSHTË HELMIMI I PALIGJSHËM I FAUNËS SË EGËR?



© VCF



© Lavrentis Sidiropoulos/ HOS

Është praktikë e turpshme e vrasjes pa dallim e kafshëve duke përdorur karrema helmues, të bërë zakonisht nga copa mishi ose karkasa të plota të kafshëve përzier me substanca helmuese, kryesisht pesticide dhe substanca të tjera toksike si cianidi dhe striknina.


Edhe pse i paligjshëm, helmimi i faunës së egër është ende i përhapur sot në Ballkan dhe Europë. Individët zakonisht synojnë kafshët grabitqare dhe kafshët e padëshiruara që konsiderohen si dëmtes dhe që mund të shkaktojnë dëme në disa aktivitete njerëzore, veçanërisht në aktivitetet e gjuetisë, blegtorisë dhe bujqësisë. Por larg nga të qenit një zgjidhje për konfliktet njeri-kafshë e egër, helmimi i paligjshëm i faunës së egër është një metodë jo-selektive dhe e rrezikshme e vrasjes së kafshëve që më tepër krijon probleme se sa "zgjidh".

HELMIMI I PALIGJSHËM I FAUNËS SË EGËR MUND TË NA DËMTOJË TË GJITHËVE NE



SPECIET E MBROJTURA PO SHKOJNË DREJT ZHDUKJES

Sot, helmimi i paligjshëm i faunës së egër, përfaqëson një nga çështjet më urgjente të konservimit. Më shumë se 2,300 shkaba janë vlerësuar të jenë helmuar në Ballkan gjatë 20 viteve të fundit, duke rezultuar në zhdukjen lokale dhe rajonale të Shkabës mjekëroshe dhe Shkabës së zezë. Sot, helmimi vazhdon të shkaktojë rënie të popullatave dhe të ndalojë rikthimin e shumë specieve të kërcënuara.



KAFSHËT E PUNËS DHE KAFSHËT E SHOQËRIMIT SHPESH BIEN PRE E HELMIMIT

Helmimi nuk bën dallim midis specieve. Edhe pse nuk janë target, kafshë të tjera si bagëtitë, qentë roje, qentë e gjuetisë dhe kafshët e shoqërimit mund të sëmuren rëndë ose të ngordhin kur hasin karrema helmues.



SHËNDETI PUBLIK NË RREZIK

Nëse substancat helmuese bien në kontakt me lëkurën ose rrugët e frymëmarrjes, njerëzit mund të përjetojnë probleme serioze të shëndetit dhe në rastin më të keq mund të shkojë deri në vdekje. Njerëzit që përdorin karrema helmues nuk janë imunë ndaj këtyre efekteve të padëshiruara – pa dashur ata vendosin në rrezik shëndetin e tyre dhe të qytetarëve të pavetëdijshëm, përfshirë të afërmit e tyre, miqtë dhe komunitetet lokale. Helmimi i kafshëve mund të prekë gjithashtu zinxhirin ushqimor të njerëzve, nga të korrat deri tek uji që pinë, duke ndikuar negativisht shëndetin e tyre.



NJË KRIM MJEDISOR I PËRCAKTUAR NË LIGJ

Vendosja e karremave helmues është një praktikë e ndëshkueshme dhe një krim mjedisor i dënueshëm me ligj. Në varësi të kimit dhe rastit, autorët mund të ndëshkohen me gjoba të rënda dhe madje me burgim.

Në Shqipëri, dënimet përkatëse mund të përfshijnë gjobë nga 100,000 deri në 200,000 lek kur vepra konsiderohet kundrvajtje administrative dhe burgim deri në 7 vite kur konsiderohet kundrvajtje penale.

METODAT E SIGURTA DHE MASAT PARANDALUESE NDAJ KARREMAVE HELMUES


Në shumicën e rasteve, individët që helmojnë kafshët e egra përballen me probleme të verteta dhe shpesh nuk janë të vetdijshëm për pasojat e dëmshme dhe që është një praktikë e paligjshme. Rritja e ndërgjegjësimit dhe ofrimi i zgjidhjeve është thelbësore në këto raste.

Ekzistojnë disa masa parandaluese dhe metoda të sigurta ndaj karremave helmues. Këto metoda mund të reduktojnë dëmet e shkaktuara në bagëti apo speciet e gjuetisë nga kafshët e tjera, duke ndihmuar në zgjidhjen e konflikteve të mundshme midis njeriut dhe kafshëve të egra, veçanërisht kafshët grabitqare.



GARDHET ELEKTRIKË

Një nga masat më efektive, gardhet elektrike që rrethojnë tufat e bagëtive apo të mbjellat në fusha mund të parandalojnë hyrjen e kafshëve që mund të shkaktojnë dëme.



FOXLIGHTS

Foxlights është një pajisje e krijuar specifikisht për të penguar grabitqarët gjatë natës duke ndezur dritat me ngjyra në mënyrë të rastësishme në ritme dhe kënde të ndryshme për të dhënë përshtypjen e pranisë njerëzore.



SISTEMI FLADRY

Një system fladry përbëhet nga flamuj të kuq, të varur në litarë që rrethojnë tufat e bagëtive, me qëllim pengimin e hyrjes së ujqërve në zonat e përzgjedhura.



QENTË ROJE TË BAGËTIVE

Qentë roje të bagëtive janë metoda parandaluese më e zakonshme dhe tradicionale, e përdorur gjatë shekujve për të ndaluar sulmet e arinjve dhe ujqërve.

Luftimi i helmimit të paligjshëm të faunës së egër me projektin "BalkanDetox LIFE"

Projekti "BalkanDetox LIFE" synon të luftojë helmimin e paligjshëm të faunës së egër në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Greqi, Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe Serbi, duke ndryshuar perceptimet dhe sjelljen e të gjithë grupeve përkatëse të interesit, nga vendimmarrësit te publiku i gjerë, përfshirë përdoruesit e karremave helmues.

Raporto një incident helmim

Heshtja ju bën bashkëfajtor. Veproni dhe na ndihmoni të luftojmë helmimin e paligjshëm të faunës së egër në Ballkan.

Keni hasur apo dëgjuar për karrema helmues, apo incidente helmimi në fshat?

Mos prekni dhe mos lu afroni karremave helmues apo kafshëve të helmuara pasi në këtë mënyrë rrezikoni shëndetin tuaj dhe investigimin e mundshëm kriminal.

Albanian Ornithological Society

Albania: +355696716127

Protection and Preservation of Natural Environment in Albania (PPNEA)

+355684334430


Mësoni më tepër rreth projektit dhe përfshihuni

Vizitoni faqen e internetit për t'u përditësuar:

www.balkandetoxlife.eu

Ndajni projektin në Facebook dhe Instagram:

@BalkanDetoxLIFE



Registrohuni në listën e postës elektronike. Nëse keni pyetje, ju lutemi kontaktoni koordinatorin e projektit: kris.dunlop@alb.org luelgjakaj@ppnea.org

Projekti "BalkanDetox LIFE" financohet nga Programi "LIFE" i Bashkimit Europian nën numrin kontraktual LIFE19 GIE/NL/001016.

Nëpërmjet këtyre aksioneve, objektivat përfundimtarë janë ndërtimi i kapaciteteve për të përmirësuar menaxhimin e incidenteve të helmimit, rritje e ndërgjegjësimit rreth pasojave të rënda të kësaj praktike, përmirësimi i bashkëpunimeve për të nxitur shkëmbimin e njohurive midis grupeve përkatëse të interesit dhe reduktimi i incidenteve të helmimit për të ndihmuar mbrojtjen e faunës së egër, natyrës dhe shëndetit publik.